



Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis

**Raport mbi arsyeshmërinë (fizibilitetin) e programit Master i Shkencave në
Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm**

Raport arsyeshmërie mbi programin Master i Shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm

1. Përmbledhje e përgjithshme mbi programin

Programi “Master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm” është hartuar konform Ligjit të Arsimit të Lartë 04/L-037 (shih [Ligji për Arsim të Lartë](#)), në Republikën e Kosovës, sipas deklaratës së Bolonjës, statutit (shih *Statuti UHZ Nr. 04-V-622* [Statuti UHZ Nr. 04-V-622](#)), të Universitetit “Haxhi Zeka”. Programi i studimeve Master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm (MSc.) është një kurikulë e studimeve të avancuara që ofron arsimim profesional dhe përgatitje të kuadrove të reja me aftësi dhe shkathtësi të rëndësishme të studimit dhe kerkimit. Është një model studimor i krijuar i cili pasuron kontekstin intelektual dhe profesional për kualifikim të kuadrove të reja me nivel të lartë të njohurive të plota në gërrshetim të dy fushave si ajo e Menaxhmentit dhe Turizmit. Kjo kurikulë ofron një lidhshmëri të qartë në mes teorisë dhe praktikave që ofrojnë bazament dhe diversitetet të udhëheqjes së bizneseve dhe krijimit të ndërmarrjeve të reja turistike-biznesore. Duke e marrë parasysh se shumica e punëdhënësve në Republikën e Kosovës janë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe poashtu një pjesë e konsiderueshme e START-UP bizneseve si dhe kërkesave aktuale të tregut dhe pritjeve të shumta në fushën e të menaxhuarit në biznes, organizimi i kurseve të studimit Menaxhment dhe Turizëm i Qëndrueshëm janë me fokus kyç drejt zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi dhe krijimit të një stabiliteti të veprimtarisë së turizmit si shtylla e katërt e ekonomisë së vendit. Gjithashtu, programi ka marrë parasysh hulumtimet e tregut të realizuara nga organizata të ndryshme që dëshmojnë se aftësitë menaxhuese të biznesit janë mjaft të kërkuara në tregun e punës. Po ashtu, këto aftësi menaxhuese parashihen edhe në dokumentin relevant (shih *Skills 2020 Kosovo*, <https://www.ef.europa.eu>).

Duke ju referuar ndryshimeve të cilat po përballin në përgjithësi ekonominë globale dhe për sfidat dhe nevojat që po krijohen nga këto ndryshime të tregut, ky program është dizenuar që të krijoj një korpus të lëndëve të cilat gjenerojnë një serë aftësish dhe kompetencash të cilat do ti ndihmojnë gjenerates së re për tu përball dhe t'i zgjidhin shumë probleme komplekse në fushën e turizmit dhe po ashtu të ndihmojnë sektorin e percjell trendet globale të zhvillimit të modeleteve të reja të biznesit turistik. Duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës në Rajonin e Pejës dhe në tërë Kosovën, ky është një program i cili ofron një sërë kompetencash në fushën e Menaxhmentit dhe Turizmit në studime

master. Prandaj, duke marrë në konsiderim rëndësinë në rritje të menaxhimit dhe ndryshimeve të medha në sfera të ndryshme, programi i studimit synon t'u ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi në praktikën e punonjësve dhe proceset e Menaxhimit për një Turizëm të Qëndrueshëm. Programi Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm kontribuon në arritjen e qëllimeve të organizatave duke menaxhuar talente, duke siguruar kënaqësi në punë dhe angazhim të punonjësve dhe menaxhim efektiv të performancës së biznesit. Misioni i programit është të kontribuojë në përgatitjen e studentëve konkurrues për tregun e punës në fushën e menaxhimit dhe turizmit, nëpërmjet kurseve dhe hulumtimeve inovative dhe mbështetëse. Programet e profilizuara të studimit, lidhja e ngushtë me komunitetin e industrisë janë disa prej elementeve të cilat kanë formësuar Universitetin "Haxhi Zeka" si një institucion cilësor të arsimit të lartë. Pozita gjeografike shumë atraktive, identifikimi i qytetit të Pejës si qytet i kulturës, si destinacion i turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe i sportit malor, domosdoshmërisht ka pasur rëndësi në profilizimin e programeve të studimit të cilat Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejës i ofron. Këto cilësi kanë bërë që UHZ të tërheq studentë jo vetëm nga regjioni i Pejës dhe Kosovës mirëpo edhe nga shtetet shqipfolëse të rajonit. Marrë parasysh që Kosova si shtet i ri i cili përballë me një shkallë të lartë të papunësisë, rreth 60% e popullatës, të cilët i përkasin moshës 18-25 vjeçare janë të papunë (*shih Rapoti i UNDP-së për strukturën e zhvillimit njerëzor*, <http://www.ks.undp.org>).

Programi është strukturuar me qëllim të përmbushjes së prioriteteve nacionale që janë (*shih Dokumenti relevant Skills 2020 Kosovo, fq. 20*, <https://www.etf.europa.eu>):

- përmirësimi i zhvillimit të aftësive dhe shkathetësive në të gjithë sektorët nëpërmjet edukimit formal, zhvillimin profesional dhe të mësuarit permanent;
- Ngritja e nivelit të përgjegjshmërisë së sistemit arsimor drejt kërkesave dhe nevojave të tregut;
- Nxitja e një qasjeje të bazuar në aftësim dhe zhvillim në bazë të kompetencave përmes mësimit të orientuar drejt praktikës dhe përmes aftësimit akademik.

Programi është i moduluar në formatin që të ketë pjesëmarrje praktike përveç asaj teorike e cila e deshmon edhe vendosjen e lëndëve të reja siq është Mesimi Praktik i cili do të jetë në dispozicionin e studentëve si kurs i përfitimeve praktike dhe profesionale të aftësive drejtpërsdrejti në vendin e punës.

Me anë të këtij programi studentët do të kenë mundësi të mendojnë dhe veprojnë si menaxherë, të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike dhe të ndërtojnë njohuritë e nevojshme në fushën e menaxhimit dhe mundësi për paisje me kompetencë dhe zotësi se si të ndërtojnë kushtet dhe standardet për një turizëm të qëndrueshëm. Praktika dhe zhvillimi i karrierës ju ofron mundësinë studentëve të operojnë në fusha të caktuara dhe të ndihen të gatshëm për punësim mbas studimeve të tyre (shih [https://unhz.eu/qendra-e-karrieres/Qendra e Karrieres](https://unhz.eu/qendra-e-karrieres/Qendra_e_Karrieres)).

2. Misioni i programit Master i Shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm

Misioni i këtij programi është plotësisht në përputhje me misionin e Universitetit "Haxhi Zeka". Misioni i programit Master i Menaxhmentit dhe Turizëm të Qëndrueshëm është që të kontribuoj në përgatitjen e studentëve konkurrues për tregun e punës, si dhe të bëhen lider të së ardhmës në fushën e Menaxhimit të Turizmit, pse jo dhe për krijimin e politikave për turizëm të qëndrueshëm që do të shërbej në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë. Ky program është në linjë të plotë me prioritetet strategjik, respektivisht me shtyllen e shtatë të prioriteteve nga Planit Strategjik 2023 – 2026 (shih [Plani Strategjik 2023 – 2026](#)), e që është "Ndërmarrësia" dhe që përpjekjet maksimale janë të orientuara për konkretizimin dhe inkorporimin punës teorike me shkathtësitë praktike të studentëve ashtu si edhe parashihet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, respektivisht niveli 7 apo cikli i dytë i studimeve sipas Bolonjës (shih KKK, 2020, <https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>). Nisur nga fakti që ekonomia e Kosovës është një ekonomi tranzicionare e cila përpos vështiresive të veta që ka me rregullativat dhe vendosjen e ligjislacionit, ky mjedis është tejet simulues për ndërmarrësit e rinj me teks të veqante në sektorin e turizmit (shih [Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas Identifikimi i hapave të mundshëm të reformës në politikën dhe legjislacionin e turizmit 2017 nga Democracy Development Institute](#)). Duke ju artibuar edhe kushteve dhe karakteristikat natyrore dhe gjeografike që mund të qojnë në krijimin e ambientit për punësime dhe vet-punësime në komunat e Rajonit të Dukagjinit (shih [Business enabling environment program Kosovo municipal competitiveness index 2012 measuring economic governance for private sector development – qasur 2 maj, 2018](#)). Nga ky prizëm programi Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm është një kurrikulë e formësuar qartë e bazuar në potencialet dhe mundësitë që ky rajon ka për zhvillim të turizmit dhe ekonomisë në përgjithësi.

Andaj, ekonomi e Republikës së Kosovës konsiderohet me një kapital njerëzor ku afërsisht 27% e popullsisë janë të moshës nga 15 deri 29 vjeç (*shih [Plani Strategjik 2023 – 2026](#)*), dhe që nxitja e frymës ndërmarrëse është parakusht për të mbështetur këtë kategori të të rinjve, e që për rrjedhojë do të ketë krijimi të mjedisit stimulues për gjenerim të vendeve të reja të punës dhe ekonomisë. Për ta inicuar frymën ndërmarrëse në mesin e të rinjve është e domosdoshme inkorporimi i ndërmarrësisë në ofertën e studimeve të UHZ-së. Marrë në konsideratë programet studimore të cilat aktualisht ofrohen nga UHZ-ja, rritja e prezencës së ndërmarrësisë si rezultat i të nxënimit për të gjithë studentët, padyshim që do të rris vet-punësimin e studentëve.

Ky prioritet strategjik në periudhë afatgjatë do të kontribuoj edhe në mirëqenie ekonomike e sociale në rajonin e Dukagjinit. Për me tutje, UHZ-ja ka ndërmarrë disa aktivitete dhe veprime të cilat nxisin krijimin e programeve të reja të cilat sikurse Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm janë derivat i shumë takimeve dhe konsultimeve me akterët kyç të rrethit të Pejës, të cilët vazhdimisht krijojnë takime dhe mbledhje të ndryshme në raport me programet dhe nevojat që ato hasin ditë pas dite. Këto veprime si: thelemimi i qendrës për përkrahje të bizneseve, qendrës së ekselencës dhe shumë organeve tjera të themeluar nga vet UHZ-ja do të krijojnë një situatë ku ky program mund të nxis ide të reja, kreativitete të reja dhe simulime të reja të komponentës së ndërmarrësisë të cilat qojnë në një zhvillim të turizmit, produkteve, ofertave, udhëzuesve të ndryshëm (*shih [STRATEGJIA & PLANI i VEPRIMIT 2020 – 2025 Zhvillimi i burimeve njerëzore për rritjen e punësueshmërisë në rajonin e Pejës](#)*) të cilët padyshim i japin një formë të re pozitive ekonomisë.

3. Rezultatet e pritura dhe të nxënimit cilësor nga programi

Programi master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm synon të ofrojë një program të strukturuar të studimit dhe kërkimit akademik dhe shkencor, të orientuara sipas nevojave të tregut dhe me pjesëmarrje aktive në ekonominë lokale, kombëtare dhe rajonale. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë në vitet e fundit duke u përball me shumë ndryshime dhe në kontinuitet të plotë me përcjelljen e trendeve të reja, ka rritur nivelin e tij drejt krijimit të profileve të reja dhe programeve të reja (*shih [Udhërrëfyeni Turistik](#)*) duke iu përshtatur kërkesës së tregut dhe nevojave të bizneseve të cilat për çdo vit dhe akreditim/ri-akreditim ka marrë rekomandimet dhe sygjerimet e biznesve të ndryshme mbi kërkesën imamente që ato kanë për burime njerëzore.

Programi master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm (MSc.) ka për objektivi t'i përgjigjet nevojës për personel (burime njerëzore) të kualifikuar, ku studentët e diplomuar nga programi master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshëm (MSc.) do të kualifikohen për të punuar në kuadër të nevojave të ekonomisë së tregut, udhëheqjes profesionale të një ndermarrjeve dhe poashtu te gatshëm për të krijuar dhe ndërtuar politika të qëndrueshme që ndikojnë drejtpërsdrejti në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e turizmit. Lidhur me këtë ekzistojnë shumë analiza dhe shumë takime të cilat kishin dhe kanë për synim të plotë krijimin e një kuadri të mirëfilltë të cilat janë edhe garantues të tregut të se ardhmes dhe pasi që janë ndërmarrë edhe shumë veprime konkrete që dalin nga një raport hulumtues i një procesi i gjatë dhe gjithëpërfshirës konsultimesh me pjesëmarrje të anëtarëve të Këshillit Lokal të Punësimit në Komunën e Pejës (KLP) dhe studentët e Universitetit "Hazhi Zeka" (shih [Plani i veprimit 2020 për realizimin e Strategjisë 2020-25 së burimeve njerëzore për punësueshmëri në rajonin e Pejës](#)) dhe bizneset lokale përgjatë gjysmës së dytë të 2018 deri vjeshtën e vitit 2019 u hartua "Strategjia e burimeve njerëzore dhe plani i veprimit për punësueshmëri 2020 - 2025 në Rajonin e Pejës" e cila përcaktoi tre objektiva për ndikim në rritjen e punësimit në Komunën e Pejës dhe rajon duke përfshirë Istogun dhe Klinën sipas organizimit të Agjencisë për Punësim të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) (shih [Plani i Veprimit: Rritja e punësimit të Rinjeve 2018 – 2020](#)). Ndonëse Strategjia është hartuar me kontribute të KLP të Komunës Pejë, ajo përfshin edhe këto dy komuna më të vogla që nuk kanë ndonjë strategji apo plan veprimi për punësim. Në bazë të analizave të gjendjes dhe nevojave të tregut është hartuar strategjia afatgjatë për punësueshmëri 2020 – 2025 dhe plani i veprimit për vitin 2020.

Nga ky raport hulumtues dalin të jenë këto objektiva strategjike me theks të veçantë:

- Zhvillimi sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore për punësim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore për punësim, dhe
- Krijimi i një tregu të qëndrueshëm dhe funksional të punës.

Prandaj, ky program mund ti jep një rëndësi të veçantë ekonomisë së Dukagjinit duke krijuar një mundësi të mirë për një orientim me mundësi administrimi uniform përmes sistemit të arsimit universitar shkencor dhe atij të aftësimi profesional (Guida turistike etj., programe aplikative) (shih [Udhërrëfyeti Turistik](#)) që konsiderohen me koston më të ulët dhe ndikimin më të lartë afatshkurtë dhe

afatgjatë. Ky opzion mund shoqërohet me aspekte të tjera komplementare si kultivimi i ndërmarrësisë, nxitja e vetëpunësimit, tërheqja e investimeve të huaja përmes partneriteteve publiko – private (PPP) si dhe levizja e fuqisë punëtore të kualifikuar përmes migrimit duke evituar “humbjen e trurit”, tërheqjen dhe mbajtjen e burimeve njerëzore me experiencë sipas avantazheve rajonale duke ofruar mundësi dhe përfituar nga kapitali dhe ekspertiza e diasporës dhe investimeve të huaja (shih [STRATEGJIA & PLANI i VEPRIMIT 2020 – 2025 Zhvillimi i burimeve njerëzore për rritjen e punësueshmërisë në rajonin e Pejës](#)).

Natyrisht që pjesa e të nxënit dhe cilësia janë ndër segmentet me të rëndësishme në program dhe padyshim së këtu një rol dhe rëndësi të veçantë luan edhe stafi i fakultetit i cili perpos që është i karakterizuar me staf të ri dhe me një profesionalizëm ai garanton dhe për bartjen e dijes dhe aftësive të cilat studentët do i marrin përmes kurseve. Por, natyrisht këto kompetenca ata i marrin në harmoni me kerksat e industrisë të cilat veq se janë identifikuar nga takimet që kanë rrjedh vazhdimisht.

Por ashtu që edhe UHZ-ja ka ndërtuar mekanizma të krijimit dhe monitorimit të cilësisë përgjatë çdo programi. Ku janë hartuar një serë aktesh si: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë (shih [Rregullorja për sigurim të cilësisë dhe vlerësim](#)), Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësim (shih [Strategjia për sigurim të cilësisë dhe vlerësim](#)) dhe po ashtu edhe manuale të ndryshme të cilat vazhdimisht janë në dispozicionin e studentëve për shërbim në lidhje me krijimin e kompetencave dhe shkathetësive praktike dhe cilësore (shih [Udhëzuesi për sigurim të cilësisë dhe vlerësim](#)).

4. Ndërlidhja e programit studimore me nevojat e tregut të punës dhe strategjitë zhvillimore

Padyshim që ky program është i krijuar që të gjeneroj një gamë kompetencash të avancuar dhe shkathetësi e mjeshtri të mirëfillta drejt studentëve të cilët do të jenë të gatshëm që ato ti përkthejnë në vendin e tyre të punës. Ky program tenton të ofroj një diferencë nga shumë drejtime tjera, ani pse Rajoni i Dukagjinit (Peja, Deqani, Juniku, Klina dhe Istogu) karakterizohen me një zonë shumë të fuqishme të turizmit dhe zhvillimit të tij. Kjo zonë është shumë e frekuentuar që posedon një potencial biznesor e turistik shumë të madh dhe shumë gjallerues për ekonominë e vendit. Këto zona identifikohen duke filluar nga një zinxhir vargore e bjeshkeve nga Istogu e gjerë tek zona e Komunes së Junikut dhe Gjakovës që përfshinë sipërfaqen prej 62.488 hektarësh i njohur si Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (shih [Turizmi në Kosovën Perëndimore Raporti](#)

[mbi Strategjinë e Tregut-Projekti Promovimi i punësimit në sektorin privat \(PPSE\) në Kosovë i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë \(SDC\), dhe implementohet nga Swisscontact](#)) të cilat edhe përbejnë një potencial të theksuar drejt një turizmi malor, eko dhe agro-bujqesor. Pa anashkaluar që këto zona janë direkt të lidhura edhe me trashëgiminë kulturore ku sipas këtij hulumtimi nxjerr që (*shih [Pilot Projekti i Zhvillimit Lokal – Rajoni i Pejës Zhvillimi i Turizmit mbi Trashëgiminë Kulturore: BE/KE Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, Raport i Studimit të Fizibilitetit, 2011](#)*) komuna e Pejës, si komuna më e madhe e regjionit përfaqeson boshtin kyq të trashigimisë kulturore dhe njëherit numrin më të madh të vizitoreve (turistëve) po ashtu ky segment i rëndësishëm i turizmit është pjesë përberëse edhe e katër komunave tjera të regjionit ku po ashtu përbejnë një potencial të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit, përkatesisht trashigimisë kulturore dhe monumenteve të identifikuar edhe përmes hulumtimit nga Plani Regjional i Trashigimisë në Kosovën Perëndimore (*shih [Plani Regjional i Trashëgimisë për Kosovën Perëndimore 2012 – 2015](#)*) i implementuar nga Këshilli Evropian (European Council) të cilat përpos zhvillimit ekonomik që turizmi mund të ndikoj ato janë të lidhura dhe monumentet kulturore dhe turizmin arkitektonik (godinat e vjetra sidomos në qytetin e Pejës).

Lidhur me STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2017-2027 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (*shih [STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2017-2027 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit](#)*) nxjerr një grup të konsiderueshëm të komponenteve bosht të krijimit të një zhvillimi të qëndrueshëm e sidomos me theks të veçantë në ndikimin në turizëm. Dhe komponentet më rëndësi të madhe janë:

- Ruajtja dhe menaxhimi efektiv i aseteve të trashëgimisë kulturore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm;
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Krijimi dhe asocimi në platformat e bashkëpunimit.

Pa dyshim që përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore krijon një qasje të integruar të cilat do ti ndihmojnë shumë programit të studimit drejt identifikimit të nevojave për zhvillim të qëndrueshëm dhe krijon kushte të mirëfillta për një implementim të shumë projekteve dhe strategjive të cilat janë të lidhura ngusht me politikën dhe planet e regjionit për tërheqje dhe mbajtje të turizmit të qëndrueshëm:

- Fuqizimi i konservimit të integruar si koncept fundamental për zhvillim të qëndrueshëm;
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në politikat dhe dokumentet kombëtare të planifikimit hapësinor;
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit komunal.

Dhe nga kjo analizë mund të dalin në rezultatin se kjo strategji është e bazuar në hapa të qartë të krijimit të kuadrove të reja drejt qëndrueshmërisë dhe nxitjes për promovimin e turizmit përmes trashëgimisë kulturore duke u lidhur po ashtu me objektivat dhe të nxënit nga programi studimor e që janë aftësite dhe kompetencat didaktike të studentëve të cilët do të pajisen gjatë studimeve. Aftësimi dhe pjesëmarrja aktive e studenteve në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përfshinë:

- Përmirësimi i “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore;
- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore;
- Edukimi i gjeneratave të reja mbi trashëgiminë kulturore.

Sipas hulumtimit të realizuar nga Komuna e Pejës dhe Organizata Jo-Qeveritare “Syri Vizion” nën financimin e Austrian Development Cooperation të vitit 2019 mbi strategjitë e veprimit për punësueshmëri (*shih [STRATEGJIA & PLANI i VEPRIMIT 2020 – 2025 Zhvillimi i burimeve njerëzore për ritjen e punësueshmërisë në rajonin e Pejës](#)*) del të jetë që baza bosht e punësimit mbeten zhvillimi i programeve të reja të cilat inkorporojnë një gamë të gjerë të aftësisve të buta, komunikative dhe profesionale të cilat nxisin ndërlidhje të lartë ndërmjet zhvillimit të programeve të reja të studimit dhe nevojave që parashtron industria në këtë rajon të parapara po ashtu edhe në hulumtimin (*shih [Vlerësimi i nevojave për shkathtësi: identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomik në Kosovë – UNDP, 2016](#)*).

Ajo që duhet të theksohet në këtë relacion lidhës është se raporti nxjerr një mundësi të krijimit të një mjedisi të lirë dhe eksplorues drejt kultivimit të kreativitetit, inovacionit dhe ndërmarrësisë në edukim dhe industri; pajisja me aftësi për zgjidhje problemesh komplekse; vetëdijesim dhe përfillja e rregulloreve mjedisore; aftësi përshtatje me pajisje, procese pune dhe materiale të reja. Po ashtu ky hulumtim nxjerr një pasqyrë të qartë të nevojave dhe kërkesave të tregut dhe industrisë në përgjithësi mbi zbrastirat të tyre dhe kërkesën që ata drejtojnë drejt institucioneve të arsimit, e specifikisht arsimit të lartë (*shih [Kosovo Rural Youth Employment Opportunities, Barriers and Needs, 2018 – LENS](#)*).

Të dalurat nga ky hulumtim sjellin një analizë mbi gjendjen e domosdoshme që duhet të veproj UHZ-ja në veqanti duke krijuar aftësitë specifike për sektorin/industrinë e caktuar sipas njohurive dhe shkathtësive që industria i kërkon (elaboruar në shqyrtim të secilës industri) përfshi këtu fushën e turizmit, mbrojtjes në punë dhe të ambientit, etj.) dhe poashtu zhvillimi i ideve/produkteve të reja, aplikimi i metodave dhe teknologjisë së re. Zhvillimi i aftësive të mirëfillta për hulumtim tregu, shitje, sjellje konsumatori, përgatitja e ofertave, pranimi i porosive dhe marketing përfshi aplikim platformash elektronike.

Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (shih [Agjencia e Regjistrimit te Bizneseve te Kosoves](#)), përkatsisht Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në tre mujorshin e fundit të vitit 2023 evidenton 940 biznese të vogla dhe të mesme (NVM) në rajonin e Pejës duke përfshirë edhe Komunitat e Klina, Istogut, Deçanit dhe Junikut, ku nga kjo shifer 286 ndërmarrje janë të sektorit të hotelarisë dhe shërbimit pa anashkaluar dhe format e shërbimeve të tjera të cilat janë pjesë e këtij sektori të cilat përbejnë afërsisht 32.8% të tregut i lidhur me veprimtarinë turistike dhe hotelere të rajonit të Pejës. Dhe mund të themi që pjesa dermuese e tyre janë pjesë e anëtarësisë së Këshillit Lokal për Punësim. Dhe patjetër që ky hulumtim ka sjell në sipërfaqe dhe mundësitë e orientimit strategjik drejt punësimit të të rinjeve në rajonin e Dukagjinit dhe me gjerë në kontekstin kombëtar.

Orinetimet strategjike drejt punësimit sipas MPMS janë të referuara në këto pika (shih [Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinje-MPMS](#)):

- Rritja e qasjes së të rinjeve, në tregun e punës, përmes ofrimit të mundësive për punësim (këshillime, orientimi në karrierë, programe studimi të bazuara në praktikë, ndërmjetësimi i punësimit përmes programeve të të ndryshme referimi, etj.);
- Rritja e punësimit përmes zhvillimit të ndërmarrësisë tek të rinjtë dhe zhvillimi i ndërmarrjeve ekzistuese, krijimi i mundësive për ide të reja dhe inkubime në pronësi të të rinjeve;
- Harmonizimi i programeve të studimit të arsimit të lartë dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës dhe ofrimi i shërbimit të orientimit dhe këshillimit në karrierë;
- Ngritja e cilësisë së mësimin në kontekstin praktik gjatë leksioneve dhe praktikës profesionale jashtë universitetit.

Ajo që ka rëndësi të theksohet në programin master i shkencave në Menaxhment dhe Turizëm të Qëndrueshmë është sepse ky program ka ndërlidhje të fort edhe me strategjitë e ndryshme të zhvillimit qofshin ato komunale të rajonit apo edhe ato nacionale. Pa dyshim që krijimi i mundësive për tërheqje të kuadrove të reja dhe avancimi i njohurive të tyre (shih [Vleresimi Strategjik Mjedisor per Planin Zhvillimor Komunal te Pejes 2019 – 2026+](#)), (shih [Plani për lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm \(SDG-ve\) në nivelin komunal komuna e Deçanit 2019](#)), (shih [Plani Zhvillimor i Komunes se Klinae 2020](#)), (shih [Plani Zhvillimor i Komunes se Istogut 2017 – 2027](#)) dhe (shih [Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2019 – 2029](#)) perkon dhe me të menaxhuarit strategjik e afatgjatë të dijes dhe kompetencës se tyre drejt integritit dhe zhvillimit të tyre për nevojat e tregut.

Lidhur me këto kushte pjesa dermuese e komunave kanë hartuar strategji zhvillimore dhe plane konkrete veprimi duke mundësuar ndërlidhjen direkte me qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi të cilat kerkojnë një mjedis të pastërt dhe konzistent dhe një orientim të qartë për një turizëm kuptimplotë. Lidhur me Planin Zhvillimor Komunal të Komunes se Pejës (shih [Vleresimi Strategjik Mjedisor per Planin Zhvillimor Komunal te Pejes 2019 – 2026+](#)) del të jetë se vlerësim strategjik kerkon nevoja të ndryshme të kuadrove për krijimin e kushteve për një ekonomi të qëndrueshme, specifikisht krijimin e një mjedisi të ruajtur me kujdes për një turizëm të qëndrueshëm. Nga ky plan dalin edhe shumë element tjerë të cilët kanë për qëllim vetëdijesimin e popullatës mbi kushtet natyrore dhe trashigiminë kulturore që ka rajoni i Pejës për një turizëm të qëndrueshëm dhe Eko.

Nga pikat e përmendura me lartë del të jetë se programi MTQ është krijuar në linjë të forta të relacionit me kushtet dhe planet që perkojnë me zhvillimin e planeve dhe strategjive të ndryshme komunale e nacionale drejt krijimit të mjedisit punëdhënës, dhe që janë direkt të lidhura me objektivat e programit. Sipas (shih [Vleresimi Strategjik Mjedisor per Planin Zhvillimor Komunal te Pejes 2019 – 2026+](#)) dhe ndërlidhjes që ka me programin MTQ perkon të jetë që identifikohen edhe mundësitë e ndryshme të zhvillimit të ofertave dhe produkteve të reja, e veqanerisht edhe llojeve të ndryshme të turizmit të qëndrueshëm e që është ai fshtar (villager) apo agro-turizmit dhe turizmit agro-pylltar. Padyshim që kjo tipe të turizmit nuk janë të vetmet që janë të parapara të theksohen në këtë plan strategjik zhvillimor, por këtu parashihet edhe turizmi rekreativ përmes atraksioneve (shih [Atraksionet turistike në Komunën e Pejës-sipas departamentit te Turizmit dhe Hotelerise nga Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise](#))

duke ju referuar me se shumti bukurive dhe atraksioneve turistike të Rugovës, Belegut, Junikut, Istogut dhe kanionit të ujërvares Mirusha etj.

Ajo që është padyshim edhe një mundësi e madhe dhe që vlen të përmendet është se sipas [Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14](#) dhe [Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor](#), do të lejohen zhvillimi i vendbanimeve dhe objekteve të ndryshme që kanë karakter zhvillimor dhe të qëndrueshëm që për të ju referuar regjionit të Pejës dhe në përgjithësi programit të studimit është rekreacioni dhe turizmi. Kjo pjesë do ti ndihmoj domosdoshmerisht edhe programit MTQ drejt një nismë të re e cila do të jetë e lidhur direkt me shtyllen e 1.7 të Planit Strategjik të UHZ-së 2023 – 2026 (shih [Plani Strategjik 2023 – 2026](#)) e që është Ndërmarrësia, ku përmes kësaj do të ndikoj direkt në nismat e reja të krijimit të bizneseve mikro dhe të vogla në këtë rajon dhe që i ndihmojnë rritjes së ekonomisë.

Programi MTQ padyshim që është program i kurrikuluar mbi bazën e identifikimeve të sakta dhe qarta mbi ofertën e kompetencës dhe shkathetësisë që do të ofroj në kuptimin e zbatimit të tyre drejt një konteksti për mbeshtetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit efektiv të turizmit në rajonin e Pejës. Ky program do të ofroj një serë potencash intelektuale që do lidhen patejtersisht me planet zhvillimore lokale dhe nacionale kundrejt një qëndrueshmërie:

- Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
- Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
- Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e koridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
- Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme;
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave;
- Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve;
- Krijimi i koridoreve të reja ekologjike;
- Zgjatja dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë shtretërve të lumenjve;
- Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në vendbanime;
- Kthimi i zonave të ndotura industriale në sipërfaqe të gjelbra etj.

5. Sfondi Socio-Ekonomik i Rajonit të Dukagjinit

Të dhënat që janë në dispozicion për këtë sektor janë shumë të kufizuara. Turizmi supozohet të kontribuojë drejtpërdrejt me më shumë se 1% në BPV-në e Kosovës dhe punëson më shumë se 9,000 njerëz (3.5% të punësimit të përgjithshëm), ndërsa kontributi mesatar botëror i turizmit në BPV është 3.3%. Lidhur me raportet mujore të gjeneruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës del të jetë se Regjioni i Dukagjinit ishte me i frekuentuari gjatë vitit të fundit prej intervalit Nentor 2022 – Nentor 2023 (shih [Agjencia e Statistikave të Kosovës Nentor 2022 – Nentor 2023](#)) respektivisht kishte 6.581 vizitor si mesatare brenda një muaji të llogaritur dhe kishte 31.498 net qëndrimi nga vizitorët dhe turistët e ndryshëm të përlllogaritur si mesatare brenda një muaji.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (shih [Agjencia e Statistikave të Kosovës TM4 2022](#)), papunësia në Kosovë varion tek vlera 12% varësisht nga burimi i informatave. Sido që të jetë, këto janë të dhëna orientuese dhe iu referohen deklarimeve në regjistrimin e popullsisë, regjistrimin e punëkërkuësve në Zyra lokale - Agjencia e Punësimit dhe MPMS, anketës së fuqisë punëtorve nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Fondi Pesional, ATK, etj. Andaj, integrimi i kësaj pjese të rinisë në shkollim/trajnim profesional e akademike në sektor sipas kërkesave të tregut do ta shpëtonte nga varfëria dhe efektet e saj dhe riste shanset e punësimit e mirëqenjes duke kombinuar veprimet me informim e këshilla.

Ndërsa raporti i një kompanie konsulente "MMC Kosova" në bazë hulumtimit të saj në vitin 2017 (shih [Millenium Challenge Cooperation](#)), paraqet gjendje shumë më optimiste të punësimit vetëm 15.6% të papunë në nivel vendi (Kosovë) që është përgjysëm më pak nga sa raportojnë statistikat e institucioneve qeveritare të Kosovës. Ndërsa në nivel rajoni, ky hulumtim rendit Gjakovën me papunësinë më të ulët (9.5%) nga 7 rajonet paraqitur në këtë hartë, pas saj renditet Prizereni (14.2%) dhe Peja me 15%, ku për afërsisht njësoj janë dhe tre rajonet tjera, kurse Prishtina ka papunësinë më të lartë prej 24.3%.

Në përmbushje të funksionit ligjor - mbledhje e raportim të dhënash lidhur me punëkërkuësit dhe si anëtare e Këshillit Lokal për Punësim në Komunë e Pejës, Zyra e Punësimit në Pejë (ZPP) raportoi statistikat në dispozicion rreth papunësisë në Komunën e Pejës deri në Gusht 2018 gjithësejt 14,637 punëkërkuës, prej të cilëve shumica janë pasiv 8467 (apo 58%) dhe 6170 (42%) aktiv.

Zyra e Punësimit në Pejë informon në mënyrë statistikore lidhur me nivelin e shkollimit dhe demografinë e punëkërkuësve aktiv. Lidhur me nivelin e arsimit, rreth 25% e punëkërkuësve aktiv janë të pa shkollë, përgjysëm më pak nga niveli kombëtar prej 57% të pa shkollë (shih [Aftësimi Profesional në Kosovë: Specifikat, Marrëdhëniet dhe Problemet, nga Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, 2014](#)), 21% me shkollim fillor, ndërsa shumica prej 33% janë me arsim të mesëm profesional, e shumë më pak me shkollim të mesëm gjimnaz rreth 5%, shkollim të lartë (bachelor) 13% dhe rreth 1% nivel master. Në kuptim demografik, raporti i ZPP tregon se meshkujt kanë një epërsi të pa përfillshme (rreth 2%) në raport me femrat punëkërkuese.

Lidhur me moshë, nga të dhënat e kësaj zyre rreth 50% e punëkërkuësve aktiv janë të grupmoshës 25-39 vjec, 22% të grupmoshës 39- 54 vjec, 19% moshë 18-24 vjec dhe 7% mbi 55 vjeç.

Lidhur me një kerkim të hartuar nga konsulenti i angazhuar (Dritan Shala, HROD) u administrua nga Qendra për Orientim në Karrierë e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë (shih [Qendra për Orientim në Karrierë e Universitetit “Haxhi Zeka”](#)). Pyetësi përmbante tre pyetje: lidhur me planin dhe nevojat për zhvillimin e bizneseve në të ardhmen e afërt 3 vjeçare, lidhur me rritjen e kapaciteteve dhe fuqisë punëtore:

- rritje kapacitetesh fizike/njerëzore/teknologjike, kualiteti/volumi, produkte të reja, marketing, etj.;
- Profilet dhe shkathtësitë e fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e planeve zhvillimore;
- Shkathtësitë e “buta” të nevojshme për fuqinë punëtore aktuale/të ardhme në përgjithësi.

Të lidhura për një rajoni i cili posedon potencial ekonomik dhe turistik vlen të theksohet se shumë ndërmarrje dhe biznese kanë shfrytëzuar praktikën dhe përvojat e ndryshme të menaxhimit të mirë dhe të suksesshëm drejt maturimit dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë. Shumë nga objektet komerciale dhe të tjera përmes investimeve private pas privatizimit janë kthyer në industri prodhuese, psh. fabrika e qumështit në Istog e cila me bashkëfinancim privat me fonde të BE-së përbën prodhuesin më të madh të qumështit të paketuar në rajon dhe Kosovë me teknologji dhe standarde ndërkombëtare.

Pastaj ka shembuj tjerë si fabrika e kërpudhave në Klinë e ndërtuar në tokën bujqësore të privatizuar, etj. si dhe qendra tregtare në Pejë, Gjakovë dhe Klinë, etj. si dhe disa prodhuese si një pjesë e kufizuar e fabrikës së drurit dhe të lëkurës, përbëjnë një nga punëdhënësit më të mëdhenj në rajon.

Prandaj bazuar në këto informacione të cilat dalin nga institucione kredibile dhe zyrtare rajoni i Pejës dhe në përgjithësi rrafshi i Dukagjinit karakterizohet me plotë mundësi të reja për tu identifikuar si potenciale të cilat ndërlidhen me planet dhe strategjitë zhvillimore komunale të këtyre komunave (Pejë, Deçan, Junik, Klinë dhe Istog) dhe të cilat i japin form dhe konturë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit.

Padyshim që Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, respektivisht Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis është në vazhdimësi drejt kerkimit të profileve dhe programeve të reja të cilat i barazvlerëson (harmonizon) programet e tyre me programet e ndryshme të universiteteve të njohura ndërkombëtare të bazuara në kompetencë praktike drejt krijimit dhe zhvillimit të aftësive intelektuale për një kontribut posterior në nevojat e tregut të punës dhe stabiliteti ekonomik të vendit.